



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 112/7 Prot.

Tiranë, më 31.03.2016

V E N D I M

Nr. 25, Datë 31.03.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË DEGËN E DOGANËS RINAS “MBI ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT DOGANOR DHE VEPRIMTARINË
EKONOMIKO FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Zbatimin e Legjislacionit Doganor dhe Veprimtarinë Ekonomiko Financiare”, për periudhën 01.10.2013-31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nisur me nr. 802/14 Prot, datë 21.03.2014 “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”, nga Dega e Doganës Rinas janë nisur kërkesat për çdo rast për DPD, e cila nuk ka përgjigje në lidhje me: -rishikimin e marrëveshjes nr. 5992/2 prot, datë 18.06.2007, të nënshkruar me subjektin “██████████”: -investigimin e faturave që u përkasin DAV, R-6168; R-12543 datë 26.10.2012, DAV R-21485, R-20235 të vitit 2012 dhe DAV R-4043 datë 28.02.2013, R-9413; R-15779 të vitit 2013: -përgjigjen nga Departamenti Teknik pranë DPD lidhur me klasifikimin tarifor të artikujve të deklaruar në praktikat doganore DAV R-10578 datë 09.06.2012, DAV R-16173, datë 20.08.2013 dhe DAV R-24890, datë 28.12.2012: - mundësinë e investimit konkret nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për ndërtimin e zyrave të administratës doganore.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 9-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nga Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Rinas të ripërsëriten kërkesat dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave ti jepet zgjidhje problematikës së cituar më sipër.

Menjëherë

2-Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se: autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas, gjatë vlerësimit të detyrimit doganor të mallrave, ka pranuar për zhdoganim nga operatorët ekonomik dokumentacion shoqërues fotokopje të pa noterizuar si: fatura e shitjes, CMR, deklarata eksportit, certifikata e origjinës, parking lista dhe në rast të veçantë edhe Euro1, veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuar nga VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Për Dispozitat Zbatuese, të KD”, Udhëzimi nr. 25, datë 30.11.2007 “Për verifikimin e Vlerës doganore”, si dhe udhëzimin e DPD nr. 6, 6/1/2 mbi vlerësimin doganor.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

-Autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas, të marr masa të plota organizative me qëllim që dokumentacioni shoqërues i pranuar në vlerësimin doganor të mallrave të administrohet me dokumente origjinale apo fotokopje të noterizuara.

Menjëherë

3-Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se: në shumicën e praktikave doganore personeli doganor që ka përpunuar praktikën doganore nuk ka plotësuar DAV-et me të gjithë treguesit e specifikuar në kuadratet përkatëse, ndërkohë vetëm ka nënshkruar, apo edhe pa vulë personale. Njëkohësisht për shumë operatorë ekonomik në përllogaritjen e vlerës doganore është pranuar çmimi me transaksion i faturës së shitjes, ndërsa për mallra me të njëjtën natyrë është ndërhyrë me koeficient, veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuar nga VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të KD” dhe Udhëzimi nr. 25, datë 30.11.2007 “Për verifikimin e Vlerës doganore”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nga Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Rinas të merren masa që praktikat doganore, të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285, 286, 287 e vijim të Kodi Doganor, si dhe të udhëzimit nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” pika 6, në të cilën thuhet: “Përcaktimi i vlerës së artikullit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar...” si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”.

Menjëherë

4. Për mallrat të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme si dhe për mallrat e përdorura, nuk është nxjerrë urdhër nga dega doganore për miratimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit, ndërkohë që për vendimet e marra nga ky komision duhej të ishte njoftuar menjëherë DPD, në zbatim të pikës 54-81 të VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, udhëzimit nr. 6, 6/1/2 të DPD “Mbi vlerësimin doganor”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Nga Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Rinas të nxirret menjëherë urdhri i brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilët nuk kanë të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD, si dhe për mallrat e përdorura.

Menjëherë

5-Nga auditimi i procedurave të zhdoganimit dhe klasifikimit tarifor të mallrave rezultoi se: autoriteti doganor kompetent Dega e Doganës Rinas, ka pranuar për zhdoganim nga operatorët ekonomik artikujt e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallit kodet tarifor “Pjesë këmbimi për automjete” për të cilat nuk ka të dhëna të disponueshme pranë kësaj dege doganore (apo të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD), veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga neni 12, pika 2 e Kodit Doganor dhe me Seksioni IV “Zhdoganimi i pjesëve të këmbimit për automjete”, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

-Autoriteti Doganor Kompetent DD Rinas, të marr masa të plota me qëllim që vlerësimi e zhdoganimi i mallrave i parashikuara në NKM me emërtimin “Pjesë këmbimi për automjete” të bëhet me miratim nga DPD.

Menjëherë

6-Nga auditimi i ushtruar në dokumentet e paraqitur nga zyra e mbikëqyrjes së magazinës doganore rezultoi se: në operatorin ekonomik nën regjimin magazinë doganore (TipiC-02), nga kryerja e inventarëve fizikë periodik kanë rezultuar diferenca të ndryshme në procesin e administrimit të regjimit të magazinës doganore, veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuar nga neni 121-135 të Kodi Doganor, VKM nr.205, datë 13.04.1999, Kreu 2, neni 247; 268; Udhëzimi nr. 3, datë 09.02.2006 “Për zbatimin praktik të përfitimit dhe operimit me regjimin e magazinimit doganor”, pika 5 “Detyrimet e administruesit të regjimit të magazinimit doganor”, paragrafi 5.2 “dorëzimi zyrtar brenda çdo datë 5 muaji pasardhës i gjendjes së stokut në degën e doganës mbikëqyrëse”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

-Autoriteti Doganor Kompetent DD Rinas, nëpërmjet Specialistes së Kontrollit pas Zhdoganimit, zyrës së Cargo dhe doganieres që ka mbikëqyrur magazinën doganore përkatëse, për diferencat e lindura nga krahasimi deklarimit të subjektit me inventarin fizik të kryer, të saktësojnë këto diferenca në ambientet e subjektit, duke i ballafaquar me dokumentacionin kontabël nëpërmjet analizës së hollësishtme me specialist të licencuar “Survejoj” me qëllim të nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë, në përfundim të rillogariten detyrimet shtesë edhe për diferencat të tjera në se mund të rezultojnë.

Menjëherë

7-Nga auditimi i ushtruar në dokumentet e paraqitur nga zyra e mbikëqyrjes së regjimeve të përpunimit aktiv (RPA) rezultoi se; nga këta operatorë ekonomik pasqyrohen diferenca të ndryshme dhe shkelje në procedurën e administrimit për sa i përket peshës bruto të mallit dhe kodet e NKM të mallit, veprime në kundërshtim me kërkesat e parashikuar nga Kodi Doganor, VKM nr. 205, datë 13.05.1999, neni 247 deri 325 dhe Udhëzimi nr. 1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

-Autoriteti Doganor Kompetent DD Rinas, nëpërmjet Specialistit të Kontrollit pas Zhdoganimit, Përgjegjësi zyrës Cargo dhe doganieri që ka mbikëqyrur (RPA), për diferencat e lindura nga krahasimi deklarimit të subjektit me formularin (Model3), për peshat bruto të saktësojnë këto diferenca në ambientet e operatorit ekonomik me ballafaqim nëpërmjet dokumentacionit kontabël dhe analizës së hollësishtme, duke nxjerrë shkaqet e përgjegjësitë e në përfundim të llogariten detyrimet e destinacionit të ri doganor.

Menjëherë

8. Gjendja e borxhit doganor është në nivele të larta me tendencë në Rritje, arkëtimi dhe vjelja e debitorëve është në nivele të ulëta dhe ka bashkëpunim të pamjaftueshëm midis DDR me strukturat e DPD dhe me institucionet e tjera me detyrim e kontribut në arkëtimin e borxhit siç janë: Zyrat e Përmbarimit, Sistemin Bankar, ZVRPP, DSHTRR etj.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 64-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

-Dega e Doganës Rinas në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të marrë masat përkatëse sipas kërkesave ligjorë dhe ato në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit duke synuar trajtimin profesional të rasteve që zënë dhe peshën më të madhe në këtë borxh.

Në vazhdimësi

9- Nga auditimi i procedurave të zbatuara mbi vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent u konstatuan disa mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", Kodit Procedurës Administrative, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 dhe Udhëzime të nxjerra nga MF e DPD për sistemin doganor.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 74-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Rinas, të marrë masa për zbatimin e kërkesave dhe afateve ligjore të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", për të vlerësuar dhe revokuar vendimet administrative për 17 operatore duke rillogaritur diferencat e sanksioneve të pa aplikuar në **vlerën 2,562,337 lekë** dhe analizuar e nxjerrë përgjegjësitë përkatëse (pasqyruar në aneksin nr. 6 bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

10. Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me nenet 142 dhe 145 të VKM 205 datë 13.04.1999, Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007 si dhe me shkresën nr. 2307, datë 07.04.2000 "Mbi përdorimin dhe administrimin e peshoreve" pika 1, "ku përcaktohet se dokumenti i fletë-peshimit pasi firmoset dhe vulozet nga punonjësi i ngarkuar, i bashkëngjitet praktikës doganore", në 14 praktika doganore nuk kishte fletë peshe në dokumentacionit shoqërues.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

-Dega e Doganës Rinas, në bashkëpunim me strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të marrë masa për vënien në funksion të peshores, të certifikuar e kalibruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me qëllim kryerjen e saktë të procedurave të importit dhe eksportit të mallrave në këtë Degë Doganore

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Dega e Doganës Rinas, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej **18,418,733 lekë** si më poshtë:

1-Vlera prej 1,672,444 lekë nga 26 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 1 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për rivlerësim të detyrimit doganor i pranuar me vlerën e transaksionit të faturës, jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore të parashikuara në neni 33- 38 të KD për periudhën viti 2014.

Afati: deri në datë 30.06.2016

2-Vlera prej 604,238 lekë nga 11 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 2 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor me keqklasifikim të artikujve jo në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave të parashikuara nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD.

Afati: deri në datë 30.06.2016

3-Vlera prej 201,325 lekë nga 2 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 3 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor me diferencë në peshën e deklaruar të artikullit jo në përputhje peshën e artikullit e pasqyruar në fletë-peshën e lëshuar nga dogana, parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 261.1/2 të KD.

Afati: deri në datë 30.06.2016

4-Vlera prej 18,740 lekë (Detyrim Doganor prej 4,685 lekë + Gjobë prej 14,055 lekë) nga operatori ekonomik “” me NIPT sipas trajtimit në faqen 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit për llogaritjen dhe vlerësimin detyrimit doganor me përfitimin e origjinës preferenciale të mallit, jo në përputhje me dokumentet shoqëruese dhe kriteret ligjore të protokollit nr. 5 të MSABE.

Afati: deri në datë 30.06.2016

5-Vlera prej 100,000 lekë nga 2 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 4 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për penalitete kundravajtjet administrative të evidentuara në procesin e vlerësimit të detyrimit doganor, parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD për periudhën viti 2014.

Afati: deri në datë 30.06.2016

6-Vlera prej 8,903,278 lekë nga operatorët ekonomik “”, me NIPT , dhe me NIPT , pasqyruar në Aneksin nr. 5 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 48-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor për diferencën e rezultuar në artikullin karburant me penalitete për kundërvajtjet administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së magazinës doganore sipas autorizimit përkatëse parashikuar nga neni 265.1/2 dhe 275 të KD për periudhën objekt auditimi.

Afati: deri në datë 30.06.2016

7-Vlera prej 292,938 lekë nga 2 operator ekonomik, pasqyruar në Aneksin nr. 5 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 48-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

për llogaritjen dhe vlerësimin e detyrimit doganor për diferencë të rezultuar e penalitet për kundravajtje administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së regjimeve të përpunimit aktiv të mallrave sipas autorizimeve përkatëse parashikuar nga neni 256.1/2/3 dhe 275 të KD për periudhën objekt auditimi.

Afati: deri në datë 30.06.2016

8-Vlera prej 6,644,510 lekë nga 2 operator ekonomik [REDAKTUAR] me NIPT [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me NIPT [REDAKTUAR], pasqyruar në Aneksin nr. 5 bashkëlidhur RPA, sipas trajtimit në faqet 48-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për mos llogaritje të detyrimit doganor dhe mos aplikim penalti për kundërvajtje administrative të evidentuara në procesin e mbikëqyrjes së Regjimit të Lejimit të Përkohshëm të mallrave në përputhje e zbatim të neneve 99, 157-164 dhe nenit 273, pikat 1 e 2 të Kodit Doganor.

Afati: deri në datë 30.06.2016

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Degës Doganore Rinas dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 dhe nenit 58 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masës, sipas nenit 59.2:

“pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 4(katër) nëpunësit civil, si më poshtë:

- A. F.** doganier për klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
- S. K.** doganier për klasifikim, vlerësim, kontroll fizik
- A. P.** , doganier për klasifikim, vlerësim, kontroll fizik,
- K.C.** , doganier për klasifikim, vlerësim, kontroll fizik pasi:

-Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 15.13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme”, nuk kanë aplikuar vlerat e të dhënave të disponueshme.

-Për veprime në kundërshtim me nomenklaturën e miratuar me VKM nr. 1067, datë 14.12.2013, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave 2014”, dhe të Rregullave të përgjithshme për interpretimin e nomenklaturës së kombinuar, nuk kanë aplikuar saktë tarifatat doganore të mallrave.

-Për veprime në kundërshtim me nenet 142 dhe 145 të VKM 205 datë 13.04.1999, Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007 si dhe me shkresën nr. 2307, datë 07.04.2000 “Mbi përdorimin dhe administrimin e peshoreve” pika 1, ku përcaktohet se dokumenti i fletë-peshimit pasi firmoset dhe vuloset nga punonjësi i ngarkuar, i bashkëngjitet praktikës doganore, në praktikat R 6614 datë 30.12.2015, R 6615 datë 30.12.2015, R 6616 datë 30.12.2015, R 6618 datë 30.12.2015, R 6619 datë 30.12.2015, R 25608 datë 03.12.2014, R 3660 datë 23.02.2014, R 2320 datë 05.02.2014, R 12159 datë 12.06.2014, R 3528 datë 20.02.2014, R 3458 datë 20.02.2014, R 2857 datë 12.02.2014, bashkëlidhur dokumentacionit shoqërues nuk kishte fletë peshe.

Shënim:

I. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor për dy ish-punonjës, ██████████

II. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 23 punonjës ██████████ është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R